

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Zgjerimi i kapaciteteve transportuese në pajisjet DWDM (Dezenjimi & upgrade)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31681000-3 - Pajisje elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT:

48,200,000 (dyzet e tetë milion e dyqind mijë) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 410,982 (katërqind e dhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 21.10.2022 (1 EUR = 117.28 ALL).

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me objekt “Zgjerimi i kapaciteteve transportuese në pajisjet DWDM (Dezenjimi & upgrade)”, ka për qëllim planifikimin, furnizimin, instalimin, integrimin me sistemet dhe rrjetin ekzistues, venien në punë, komisionimin dhe testimin e të gjithë bordeve që do instalohen si dhe linjave të transmetimit të sinjaleve si dhe të të gjithë sistemit në teresi. Ky rrjet është i lidhur dhe funksionon si një i tere. Ndarja në lote mund të shkaktonte probleme konfigurimi dhe nderlidhje me pjesët e tjera të rrjetit të një loti tjetër dhe në këtë mënyrë vështirësimin ose mosfunksionimin e të gjithë parametrave teknike.

Referuar procedurës së prokurimit, periudhës së emergjencës COVID-19, e cila ka shkaktuar shumë here mungesë të disponibilitetit dhe vonës në dorezimin e mallrave apo kryerjen e shërbimeve të caktuara, AK vlerëson se kjo procedurë prokurimi nuk mund të ndahet në Lote, pasi krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa Operatore Ekonomik mund të sjellë përdorshmeri të perkohshme ose vonës të shumta në funksionimin e pajisjeve dhe materialeve të cilat mund të furnizohen nga një tjetër Operator Ekonomik, kontraktor i një loti tjetër.

AK nuk mund te dispononje nje element nga mallrat objekt prokurimi ne vete dhe te prese furnizimin e mallrave te tjere, ne qofte se keto jane te ndara ne lote.

AK eshte nje institucion i rendesise se vecante ne sistemin elektro-energjitik shqiptar dhe gjithashtu ben edhe lidhjet e nevojshme me vendet fqinje dhe per kete arsye.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit te Transmetimit**” (OST) sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 90,000,000 (nentedhete milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e sipërper mendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros të jete në masën 90,000,000 (nëntëdhjetë milion) Leke. Kjo vlerë e përcaktuar është vlerësuar e tillë për shkak të rritjes së cmimeve të tregut dhe luhatjes që mund të ketë deri në realizimin e plotë të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 19,000,000 (nente mbedhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me këtë pikë:

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohej vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shenim: *i) Për vetë natyrën e kësaj procedure prokurimi, Kontrata të ngjashme do të konsiderohen ato të cilat kanë instalimin apo mirëmbajtjen e sistemeve të transmetimit apo aksesit në fushën e telekomunikacioneve me operatore të rendesishëm të fushës.*

ii) Për shkak të natyrës së kësaj procedure prokurimi, furnizimi apo mirëmbajtja e sistemeve IT nuk mund të konsiderohet si kontratë e ngjashme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën afërsisht 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afërsisht 39 % të vlerës së fondit. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar në stafin e tij punonjësit e nevojshëm për realizimin e kësaj kontrate, për një periudhë prej 2 (dy) vjet nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, si vijon:

- *2 (dy) inxhinierë telekomunikacioni/elektronik*
- *2 (dy) punonjës të certifikuar për pajisjet specifike që do të mirembahen objekt prokurimi.*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë diplomat dhe certifikatat përkatëse të punonjësve, CV dhe kontratat e punës të vlefshme.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për inxhinierët dhe punonjesit e sipërpërmendur është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e tij tregtar këtë natyrë aktiviteti. Kjo kërkesë për kualifikimin e nevojshëm profesionale është në përputhje me Nenin 40, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat perkatese të vlefshme të ISO, të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:*

- *ISO 9001: Për sistemin e menaxhimit të cilësisë.*
- *ISO 27001: Për menaxhimin e sigurisë së informacionit.*
- *ISO 18001: Per sistemin e menaxhimit të shendetit dhe sigurise ne pune.*

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Është e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të vertetuar dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001: është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit. Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht në sistemin elektro-energjitik, gjykohet se informacioni duhet mbrojtur dhe Kontraktori objekt procedure prokurimi, duhet të nderhyjë në sistemin e brendshëm të AK. Certifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurinë e nevojshme AK.

Certifikata per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ISO 18001: është e nevojshme si kriter kualifikues, pasi lidhet me natyrën e kontratës dhe garanton AK-ne, që ecuria e kontratës nuk do të pengohet apo vonohet nga mundësia e aksidenteve apo demtimeve të punonjesve gjatë realizimit të saj, duke patur në konsideratë faktin se realizimi i objektit të kontratës ka rrezikshmeri nga kushtet e punës së punonjesve.

AK duhet te marre çdo mase te nevojshme per parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarise se saj, ku per shkak te moscertifikimit te duhur te kontraktoreve, AK duhet te pezulloje ose te vonoje veprimtarine e saj, duke shkaktuar nje dem te madh ne sistemin elektro energjistik shqiptar, ku eshte edhe objekti i saj kryesor.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate qe mallrat e furnizuara jane te reja (jo te rikonstruara).*

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të kete garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, eshte vendosur në përputhje me piken 6, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 **TABELA E ARTIKUJVE/MALLRAVE**, paraqitur nga Autoriteti Kontraktor me poshte, duhet te plotesohet rigorozisht nga Ofertuesi, per te gjithë artikujt e tabelës qe kerkohet. Te kjo table nga ofertuesi duhet te plotesohet: Emri i kompanise prodhuese, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. i faqes se ketij katalogu si dhe Nr. references ose Kodi i artikullit nxjerre nga manuali i prodhuesit, per te gjithë ato artikuj qe kerkohen ne kete table:

Plotesuar nga AK			Duhet te plotesohet nga OE			
Nr.	Përshkrimi i mallit	Sasia	Emri i kompanise prodhuese	Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit	Nr. i faqes se katalogut	Nr. references ose Kodi i artikullit nxjerre nga manuali/ katalogu i prodhuesit
1	Pajisjet 8800 OTN/DWDM hardware + software (1x 100G) zberthuer 10x10G Porte+ SFP per distance 80 km) _Ns/ Gjirokaster	1				
2	Pajisjet 8800 OTN/DWDM hardware + software (1x 100G) zberthuer 10x10G Porte + SFP per distance 60 km) _Ns/Shkoder	1				
3	Pajisjet 8800 OTN/DWDM hardware + software (1x 100G) zberthuer 10x10 g Porte SFP per distance 40 km) _Ns/Fier	1				
4	Pajisjet 8800OTN/DWDM , hardware + software (5x 100G) zberthuer 5 katra 10x10G Porte+ SFP per distance 10 km) _Ns/Tirane	5				

5	Pajisjet 8800 OTN/DWDM hardware + software (1x 100G) zberthuer 10x10G Porte+ SFP per distance 40 km) _Ns/Prenjas	1				
6	Pajisjet 8800 OTN/DWDM hardware + software (1x 100G) zberthuer 10x10G Porte+ SFP per distance 40 km) _Ns/Peshkopi	1				
7	Pajisjet DWDM hardware + software , 2 x TN12M40V01 Multiplexing Board With VOA	2				
8	Pajisjet DWDM hardware + software, 2 x TN12D4001 (Demultiplexer me 40 kanale).	2				
9	Pajisjet DWDM hardware + software ,2 x TN55NO201 (Bord aksesit 8 x 10G)	2				
10	Pajisjet DWDM hardware + software 2 x TN11DCU03 (Bord i kompesimit te dispresionit, 60km)	2				
11	Pajisjet DWDMhardware + software4 x TN13DCP01 (Bord mbrojtës me 2 kanale)	4				
12	Pajisjet DWDM hardware + software 2 x TN13OAU101 (Bord Amplifikator, 0 dBm IN & 20dB OUT, Gain 20~31dB)	2				
13	Pajisjet DWDM hardware + software 2 x TN13OAU103 (Bord Amplifikator, -4dBm IN & 20dB OUT, Gain 24~36dB)	2				
14	Pajisjet DWDM hardware + software 2 x TN15OPM801 (Bord monitorimi i sinjalit optik me 8 kanale (C_Band, 192.05~196.075THz, 37.5GHz~400GHz)	2				
15	Licencat ne NMS (Network Managemnt Sistem) dhe licensave te NE (Network Element)	21				

Mosplotesimi korrekt i tabelës, është element skualifikues.

Argumentimi: Plotësimi i këtij kriteri është vendosur në vijim të përcaktimeve të Nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, me qëllim shmangien e mundësive për keq-kuptimin dhe keq-referimin nga ofertuesi të specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara. Kjo e garanton AK-në se ofertuesi e njeh konkretisht produktin e kërkuar dhe merr përsipër paraqitjen e tij pa asnjë devijim nga sa kërkohet në DT. Ky kriter është vendosur në proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Zgjidhjen Teknike për menyrën e lidhjes në menyrë të qartë e të detajuar, sipas parashikimeve të bera në piken 5.1 të Specifikimeve Teknike (Shtojca 5 e DST).

Argumentimi: OE ofertues duhet të paraqesë zgjidhjen teknike, për arsye të shqyrtimit të kapacitetit të tij, në përputhje me Specifikimet Teknike të pasqyruara në DST.

2.3.8 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik".